

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË 23 SUBJEKTE AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE DHE MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE, SHPËRBLIM DËMI, DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE ” PËR PERIUdhËN 01.01.2014 – 31.12.2014.

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në 23 subjekte auditimi “Mbi zbatimin e rekomandimeve dhe marrjen e masave organizative, shpërblim dëmi, disiplinore dhe administrative”, për periudhën 01.01.2014 deri në 31.12.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 17, datë 28.02.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimimi i masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të reflektohen në Raportin Vjetor të Veprimtarisë së KLSH të dhënat e siguruar nga verifikimi i rekomandimeve të lëna në 23 subjekte të audituara në vitin 2014, që do të paraqitet në Kuvend në muajin mars 2014.

2. Nisur nga fakti se në vitin 2014, në 23 subjekte Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm për përmirësimin e gjendjes ka rekomanduar gjithsej 756 masa dhe propozime. Të gjitha institucionet kanë kthyer përgjigje brenda afatit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH dhe përgjithësisht kanë pranuar rekomandimet e lëna.

Sipas të dhënave që paraqet Raporti Përfundimtar i Auditimit për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga 756 rekomandime të lëna, **janë zbatuar plotësisht 519, ose 69 % e tyre**, janë zbatuar pjesërisht 19 rekomandime ose 2.5 % e tyre, janë pranuar dhe kanë nisur procedurat e zbatimit për 132 rekomandime ose

për 17 % të tyre e për rrjedhojë i konsiderojmë në proces zbatimi, si dhe **nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar 86 rekomandime ose 11,5 % e tyre**. Në mënyrë të detajuar zbatimi i rekomandimeve për çdo institucion është trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit

Të analizuar sipas natyrës zbatimi i rekomandimeve paraqitet:

a. Për **përmirësimin e dispozitave ligjore** janë propozuar 55, rekomandime, nga të cilat 30 janë zbatuar plotësisht, 16 rekomandime janë në proces zbatimi dhe 9 rekomandime janë të pa zbatuara.

b. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 482, **masa organizative**, nga të cilat 330 janë zbatuar plotësisht, 19 rekomandime janë realizuar pjesërisht, 94 rekomandime janë në proces zbatimi dhe 39 rekomandime nuk janë zbatuar.

c. Për dëmet ekonomike të shkaktuara janë propozuar 90, **masa për shpërblimin e dëmit** në shumën 1,931,861 mijë lekë, nga të cilat janë kontabilizuar dhe kanë nisur procedurat e zbatimit për 55 rekomandime në vlerën 861,500 mijë lekë, janë në proces zbatimi 20 rekomandime në shumën 330,973 mijë lekë dhe janë të pa zbatuara 15 rekomandime në shumën 736,388 mijë lekë.

d. Janë rekomanduar 31, **masa administrative**, nga të cilat 26 janë realizuar, 2 rekomandime janë në proces zbatimi dhe 3 rekomandime janë të pa realizuara.

e. Janë rekomanduar 98, **masa disiplinore**, nga të cilat 78 janë realizuar dhe 20 masa janë të pa realizuara.

3. Nisur nga fakti se niveli më i ulët i zbatuar reflektohet në përmirësimin e bazës ligjore të përcaktuar, si dhe duke patur parasysh rëndësinë që kanë këto rekomandime në procesin e miratimit të fondeve publike, është **rirekomandu**ar:

3.1. Në Ministrinë e Financave

Zbatimin e rekomandimeve të lëna me shkresën nr. 273/8 datë 24.09.2014, për përmirësimin e dispozitave ligjore e nënligjore që janë në proces dhe të pa zbatuara si më poshtë:

A/1 Ministria e Financave të përshpejtojë të gjitha masat për hartimin e një kuadri rregullator fiskal, i cili të synojë reduktimin e nivelit të borxhit publik në një periudhë të përcaktuar kohore dhe sigurimin e një qëndrueshmërie afatgjatë të borxhit publik.

-Përgatitjen dhe paraqitjen e një iniciative ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të indikatorit të borxhit publik ndaj PBB-së, në nivelin 60 % dhe arritjen e këtij niveli në terma afatgjatë.

A/3. Shqyrtimi i ndryshimeve të parashikuara në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe miratimi i tij në Kuvend të bëhet me një shumicë të cilësuar parlamentare.

A/4 Në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të përcaktohet që të ardhurat nga privatizimet duhet të përdoren së pari dhe kryesisht për të ulur borxhin publik, ku 50% të jetë kufiri i poshtëm, dhe pjesa tjetër prej 30 % të përdoret për financimin e investimeve kapitale si dhe 20% për dëmshperblimin ligjor të ish të përndjekurve politike.

A/6 Në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të parashikohet në një nen të veçantë mënyra e procedimit të skemës së planifikimit dhe miratimit të fondeve të Institucioneve të Pavarura Kushtetuese, si dhe mos cënueshmëria e këtyre fondeve përgjatë vitit.

A/9 Në Ligjin Organik të Buxhetit që do të rinovohet të përcaktohet, që Vendimet e Këshillit të Ministrave për përdorimin fondit rezervë të buxhetit të Shtetit, të merren pas miratimit paraprak me shkrim i Ministrit të Financave, duke shmangur në këtë mënyrë përdorimin e këtyre fondeve nga institucionet përfituese pa relacion shpjegues, pa preventiv shpenzimesh, apo përdorimi i këtyre fondeve si "shtesë buxheti".

A/10 Nga Ministria e Financave të nxirret një udhëzim në të cilin të përcaktohen qartazi struktura dhe përmbajtja e ligjeve të planifikimit të buxhetit dhe buxhetit faktik i cili paraqitet në Këshillin e Ministrave e më pas në Kuvend.

Në këtë udhëzim të përcaktohen veprimet nga pikëpamja procedurale që duhet të ndiqen nga Drejtoria e Thesarit për nxjerrjen e treguesve buxhetore faktike.

A/12 Një koordinim më të mirë me politikën monetare referuar faktit që kredimarrja nga Banka e Shqipërisë i kalon kufijtë afatshkurtër, ose saktësime ligjore në Marrëveshjen midis Bankës dhe Ministrisë së Financave, të cilat lidhen me kreditimin afatshkurtër.

A/13 Nga Ministria e Financave në udhëzimin e zbatimit të buxhetit të përcaktohen kritere dhe limite për shumatat e fondeve, të cilat mund të avancohen si dhe periudhën nga do avancohen këto fonde, me qëllim ruajtjen e ekuilibrave të të ardhurave, shpenzimeve dhe deficitit buxhetor, përgjatë gjithë vitit.

A/17 Të punohet për rishikimin e plotë të Manualit të Auditimit, për ti dhënë plotësinë si në parime dhe në metodologjitë e planifikimit dhe vlerësimit të riskut, në formate raportimi që do të mundësonte lexim të njëjtë të gjetjeve dhe konstatimeve pavarësisht në cilën strukturë raportohen. Duhet të vlerësohen problematikat e punës së përditshme të audituesve në këtë

sektor në mënyrë që të reflektohet çdo mangësi e deritanishme për të bërë një material që të jetë në koherencë me standardet ndërkombëtare por edhe ti rezistojë mjedisit shqiptar. Duhet të plotësohet me elementët bazë të parandalimit dhe zbulimit të skemave të mashtrimit nga audituesit e këtyre strukturave.

A/18 Ministria e Financave të ndërmarrë iniciativën ligjore për përmirësimin e VKM nr 212 datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësisve të auditimit të brendshëm në sektorin publik” me qëllim që:

a. Të përcaktohen kriteret e matshme për ngritjen dhe funksionimin e NJAB, siç mund të ishin:

- Numri i subjekteve që do të auditojë NJAB.

- Numri i subjekteve vartëse, objekt auditimi i NJAB.

- Fondet buxhetore që kanë në administrim Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, objekt auditimi i NJAB.

- Numri i punonjësve që janë të punësuar në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, objekt auditimi i NJAB; etj.

b. Për rastet kur në njësitë shpenzuese, nuk ngrihet njësi e auditimit të brendshëm, të përcaktohen mënyra e kontraktimit për realizimin e shërbimit të kontraktimit dhe tarifat që duhet të përfitojnë njësitë e auditimit të brendshëm për realizimin e këtij shërbimi.

A/22 Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave, në bashkëpunim me asistencën e huaj të përgatitin një draft për hartimin e një ligji të ri për kontabilitetin dhe një udhëzim të ri për mbylljen e llogarive vjetore të institucioneve buxhetore, duke përcaktuar një strukturë të plotë për hartimin e bilancit të shtetit, në mënyrë që çdo vit shteti shqiptar të disponojë përmbledhësen e llogarive vjetore të gjithë institucioneve të tij.

A/23 Nga Ministria e Financave të nxirret një udhëzim, në të cilën të përcaktohen procedurat që duhen ndjekur në rastin e transferimit të veprimtarive institucionale të Ministrive apo institucioneve shtetërore dhe që shoqërohen me shpenzime të fondeve buxhetore. Në këtë udhëzim ndër të tjera të parashikohet që nga institucionet të ndërrmeret një analizë e hollësishme e preventivimit të shpenzimeve të ardhshme të nevojshme, të cilat do të mundësojnë kryerjen e veprimtarisë normale, të konsiderohen investimet e kryera më parë deri në momentin e transferimit, duke mos shkaktuar dëme ekonomike për buxhetin dhe të kryhet një analizë kosto përfitim.

A/25 Në udhëzimin e monitorimit të buxhetit nga Ministria e Financave të përcaktohet standardi i paraqitjes së një raporti monitorimi për pjesën e analizave monitoruese ku domosdoshmërisht duhet të përmbajë:

a. Ndryshimet buxhetore nga plani fillestar deri në planin përfundimtar.

b. Analizat e ndryshimeve të produkteve të programeve nga planifikimi fillestar si rezultat i: shtesave/ pikësimeve të fondeve buxhetore me akte ligjore apo nënligjore; ndryshime të fondeve buxhetore brenda programeve, ku ndryshohen emërtimet e projekteve apo produkteve; ndryshime të fondeve buxhetore si rezultat i transferimeve të fondeve nga programi në program, duke ndryshuar kështu sasinë e produkteve apo kostot e tyre.

c. Argumentimet e mosrealizimit të produkteve dhe masat e marra për ti realizuar ato në të ardhmen.

d. Argumentet e ndryshimit të kostove të produkteve dhe sidomos kur ato paraqiten me kosto shtesë.

e. Të dhënat për realizimin e financimit të huaj dhe analiza e tyre

f. Të dhënat për realizimin e të ardhurave jashtë limitit dhe analiza e tyre.

- Nga Ministria e Financave të përmirësohen formatet e treguesve të realizimit të buxhetit që i bashkëlidhen raportit analizë të monitorimit dhe kryesisht formatet e paraqitjes të realizimit

të produkteve të programeve në sasi dhe vlerë ku këto të paraqiten në prognozë duke pasqyruar të gjitha ndryshimet e buxhetit.

3.2 Në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit

Zbatimin e rekomandimeve të lëna me shkresën nr. 955/7 datë 31.03.2014, për përmirësimin e dispozitave ligjore e nënligjore që janë në proces dhe të pa zbatuara si më poshtë:

A/1 Në zbatim të ligjit nr. 9863, date 28.01.2008” Për ushqimin” të ndryshuar me ligji nr. 74/2013 nga AKU dhe MBZHRAU të hartohet vendimi dhe t’i propozohet Këshillit të Ministrave “ Mënyra e vjeljes së gjobave dhe shpërndarja e tyre”.

- Të verifikohen aktet e lënies së gjobave nga çdo DRAKU si dhe nga AKU hedhja e plotë e tyre në sistemin AKU – net për vitin 2012- 2013, si dhe të kryhet kontabilizimi i gjobave të pa arkëtuara për vitet e mësipërme.

A/3 MBUMK dhe Drejtoria e Përgjithshme e AKU, të marrë masa për përcaktimin e standardeve ushqimore të çdo produkti në veçanti dhe për nën produktet e tyre, konform standardeve të Komunitetit Evropian që shoqërojnë produktet që importohen, si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse të tyre.”

3.3 Në Autoritetin Rrugor Shqiptar

Zbatimin e rekomandimit të lënë me shkresën nr. 246/12, datë 04.08.2014, ndryshuar me shkresën nr. 246/19, datë 09.09.2014, për përmirësimin e dispozitave ligjore e nënligjore që është e pa zbatuara si më poshtë:

A/3 Autoriteti Rrugor Shqiptar, të kërkojë nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, të bëhen shtesa në kreun II, të UKM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime, për rastet kur zërat e punimeve, volumet e të cilave në kontratat shtesë rriten me më shumë se 25% të volumeve të kontratës bazë, të konsiderohen si zëra punimesh jashtë kontratës bazë.

3.4 Në Institutin e Sigurimeve Shoqërore Tiranë

Zbatimin e rekomandimeve të lëna me shkresën nr. 177/8, datë 30.06.2014 për përmirësimin e dispozitave ligjore e nënligjore që është e pa zbatuara si më poshtë:

A/4 Realizimin e një marrëveshje dypalëshe me të gjitha ndryshimet e nevojshme që kanë rezultuar nga zbatimi i VKM nr. 1114, datë 30.07.2008, dhe në referencë edhe të bazës rregullatore që do të konkludohet nga miratimi i ndryshimeve ligjore të synuara nga strategjia.

- Në marrëveshje të përcaktohen procedurat e dërgimit të informacionit të nevojshëm deri në përfundimin e përshtatshmërisë së sistemit të informatizimit të DPT me programin informatike pritës të të dhënave në ISSH si dhe afatet kohore të qarta sipas nevojave për këtë informacion për një vendimmarrje të drejtë në menaxhimi e kësaj skeme.

A/5 Përfshirjen në aktet përkatëse të ndryshimit nga reforma në sigurimet shoqërore edhe të propozimeve të bëra dhe të miratuara në parim në Projektvendimin e Këshillit të Ministrave për organizimin e KMCAP Eprorë.

A/6 Përfshirjen në aktet e ndryshimeve nga reforma në sigurimet shoqërore të mënyrës së trajtimit të kësaj problematike të konstatuar ku të specifikohet qartë mënyra e llogaritjes së kontributit dhe tatimit mbi të ardhurat, për raportet mjekësore, të paguar deri në 14 ditë nga punëdhënësi.

3.5 Në Bankën e Shqipërisë

Zbatimin e rekomandimeve të lëna me shkresën nr. 188/8, datë 15.09.2014 për përmirësimin e dispozitave ligjore e nënligjore që janë të pa zbatuara si më poshtë:

A/1 Përfaqësimi i administrimit në Këshillin Mbikëqyrës të bëhet vetëm nga Guvernatori, pasi gjykojmë se një përfaqësim i tillë do ti jepte hapësirën e nevojshme Këshillit Mbikëqyrës për të kryer saktësisht funksionet mbikëqyrëse që atij i atribuohen me ligj dhe shmang pozitën “dominuese” të administrimit në Këshillin Mbikëqyrës (3 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës janë ligjërës në nivelin më të lartë të administrimit). Eksperienca e bankave qendrore të vendeve të zhvilluara ka dëshmuar se prania vetëm e Guvernatorit në nivele të tilla vendimmarrëse është mëse e mjaftueshme dhe ndarja e funksioneve të administrimit nga politikëbërja dhe mbikëqyrja sjellin efekte pozitive në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në mënyrën e administrimit të fondeve në dispozicion.

- Të saktësohen më mirë detyrat funksionale të Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorëve të Bankës me synimin për të shmangur dualizmin e funksioneve, konfliktin e kompetencave dhe për të siguruar një nivel të dëshirueshëm llogaridhënie, transparence dhe mbikëqyrjeje.

- Referuar përcaktimeve të bëra në nenin 44 të Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për mënyrën dhe procedurën e propozimit në Kuvend të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, rezultoi që kompetenca e pakufizuar e Presidentit të Republikës, për të përzgjedhur Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, sanksionuar në nenin 161, pika 2 të Kushtetutës, kufizohet artificialisht nga dispozitat e ligjit organik.

Për këtë rekomandojmë që në procedurat ligjore për propozimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, ligji organik të reflektojë frymën e nenit 161, pika 2, të Kushtetutës në bazë të së cilës, Presidenti nuk ka asnjë kufizim për sa i përket përzgjedhjes nga ana e tij të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

A/2. a. Me synim rritjen e besueshmërisë dhe përgjegjshmërisë në qeverisjen e Bankës, të bëhen përmirësime ligjore për të garantuar efektshmërinë e kësaj strukture në dhënien e sigurive të arsyeshme mbi funksionet dhe sistemet e kontrollit brenda saj, duke transformuar funksionin e Inspektorit të Përgjithshëm në një Komitet Auditimi të përbërë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi.

A/2. b. Të bëhet ndryshimi i mënyrës së përzgjedhjes së audituesit të pasqyrave financiare duke ia kaluar këtë kompetencë Kuvendit të Shqipërisë, referuar edhe praktikave më të mira botërore.

A/2. c. Në ligj duhet të shprehet domosdoshmëria e bashkëveprimit institucional të këtyre subjekteve të kontrollit (Auditimi i Brendshëm, i Jashtëm dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit) në funksion të ofrimit të një sigurie maksimale në kushtet e shfaqjes së risqeve të ndryshme të lidhura sidomos me veprimtarinë investuese dhe operacionale të Bankës si dhe për të rritur besueshmërinë në vërtetimin e gjendjen financiare të

Bankës Qendrore, interpretimin e saktë të pasqyrave financiare për të nxjerrë në dritë dallimet në mes objektivave lidhur me stabilitetin monetar dhe financiar dhe rezultatit të Bankës.

A/3. Të vendoset kufizimi i plotë i pjesëmarrjes së tyre në këshilla dhe borde të tjerë përveç atyre të fushës akademike dhe shkencore.

- Të kërkohet mospërdorimi i figurës në aktivitete apo promovime që cenojnë integritetin e figurës së anëtarit të një bordi kaq të rëndësishëm.

- Kufizimi i daljeve publike dhe mbajtjes së qëndrimeve individuale mbi aspekte të politikës monetare në një kohë që paraqitet një qëndrim i Këshillit Mbikëqyrës në deklaratën për shtyp të Guvernatorit, pasi kjo mund të nxisë refleksione dhe reagime jokorrekte të operatorëve në treg.

- Ndërkohë, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e tyre në jetën publike dhe ekonomike të vendit, dhe vetë sfidat që ka përpara ky Institucion i rëndësisë së veçantë, për t'u përballuar me realitete të mbartura nga e kaluara, i kërkojmë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të japin dorëheqje nga bordet dhe pjesëmarrjet e tjera publike dhe politike dhe aq më tepër përdorimit të figurës së tyre, në dobi të bizneseve private, përfshirë dhe ato të reklamimit të sistemit universitar privat në vend.

A/4. a Nisur nga fakti se mungesa e përcaktimit të saktë të llojit dhe masës së shpërblimit për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në ligj, ka krijuar hapësirën për një vendim të tillë, rekomandoj që të plotësohet në ligj lloji, masa dhe numrin total të shpërblimeve që mund të përfitohen nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Gjykojmë se një plotësim i tillë do të eliminonte rastet e keqinterpretimit të të drejtës që ligji përcakton në nenin 45.

- Ndërkohë, lidhur me këtë konstatim i rekomandoj Bankës së Shqipërisë, plotësimin e mëtejshëm të dispozitave ligjore për vendosjen e rregullave të qarta lidhur me llojin, masën dhe kohën e shpërblimeve të Këshillit Mbikëqyrës. Çdo vendimmarrje në të ardhmen të realizohet duke marrë në konsideratë shmangien e konfliktit të interesit ndërmjet vendimmarrësve dhe përfituesve të këtyre shpërblimeve duke synuar kështu kombinimin më të mirë të pavarësisë institucionale dhe financiare që ligji i ka atribuar Bankës dhe miradministrimit të kësaj pavarësie.

A/4. b. Rishikimin e ligjit, në frymën e minimizimit të riskut potencial të abuzimit me pavarësinë dhe shmangies së konfliktit të interesit që evidentohet në praktikën e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve për nivelet drejtuese.

- Përcaktimi i një kornize të kujdesshme rregullatore në lidhje me nivelin e pagës së Guvernatorit, e cila duhet të ndjekë trendin e pagave të tregut bankar, por gjithmonë duhet të jetë në raporte të pranueshme krahasuar me pagën e Presidentit të Republikës, bazuar kjo jo vetëm në përvojat dhe praktikën më të mira të vendeve të ngjashme, por edhe në përshatshmërinë me realitetin shqiptar.

- Kërkesën për një transparencë të detyrueshme ligjore për çdo vendim të lidhur me pagat dhe shpërblimet e stafit dhe jo vetëm, çka presupozon informimin e vazhdueshëm të opinionit të gjerë publik në lidhje me çdo përfitim financiar dhe monetar.

A/5. Kuvendi të bëjë plotësimin e nenit 73 të Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, në mënyrë që të saktësojë pozicionin e Bankës përballë kërkesave të ligjeve në fushën e tatimeve dhe doganave, për të eliminuar keqinterpretimet që kanë sjellë praktikën e deritanishme.

A/6. Kuvendi të amendojë nenin 110, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, në mënyrë që edhe për këtë fond të zbatohen dispozitat ligjore të këtij ligji ose,

- Kuvendi të iniciojë hartimin e një dispozite të plotë ligjore për të rregulluar politikën e administrimit, procedurat për miratimin e politikës së investimit të fondit privat të pensionit si dhe vendosjen e një kufiri maksimal page mbi të cilën të llogariten kontributet që Banka duhet të paguajë për këtë fond.

Kemi rekomanduar dhe vazhdojmë të rekomandoj që procedurat e nevojshme në lidhje me shqyrtimin, vlerësimin dhe përgatitjen e ndryshimeve dhe përmirësimeve ligjore, të iniciohen nga vetë Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim të ngushtë dhe partneritet me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore dhe Bankën Qendrore Evropiane, duke ia përcjellë më pas si propozim Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit. Gjykojmë që iniciimi i këtyre propozimeve ligjore nga vetë Banka e Shqipërisë do shmangte çdo ndikim të mundshëm në pavarësinë e këtij institucioni.

Si rrjedhojë, në shqyrtimin që do ti bëhet propozimeve të mësipërme ligjore, Kuvendi, duhet të ketë një vendimmarrje të administruar me kujdes për të mos cenuar por dhe mos rrezikuar në asnjë moment pavarësinë e Bankës së Shqipërisë për shkak të rasteve të keqadministrimit apo vlerësimit jo të kujdesshëm të funksioneve administruese dhe mbikëqyrëse të saj. Theksojmë se duhet të respektohet institucioni i lartë i Bankës së Shqipërisë si një institucion i rëndësishëm të cilit Kushtetuta në nenin 161 të saj, i jep të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës shqiptare, të zbatimit të pavarur të politikës monetare dhe të mbajtjes e të administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë. Ndërhyrja duhet të jetë e kujdesshme dhe duhet të kryhet në bashkëveprim dhe respektim të mendimit të Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve financiare ndërkombëtare partnere, në mënyrë që të ruhet i paprekur stabiliteti monetar e financiar, i cili është lehtësisht i cenueshëm nga sinjale negative apo keqinterpretime të pakujdesshme.

Në kërkesat që do tu drejtohen subjekteve të mësipërme për të rikërkuar zbatimin e rekomandimeve, të shënohen të plota rekomandimet që janë në proces zbatimi dhe ato që nuk janë zbatuar.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Nikoleta Piranjani, Pjetwr Beleshi dhe Yrjada Jahaj, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe nga Drejtori i Departamentit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT